



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Bordi

VENDIM

Nr. 190, Datë 23.11.2017

**MBI  
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E PAGESAVE TË  
RREGULLIMIT PËR TË LICENSUARIT NË SEKTORIN E ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 17, pikat 4, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.11.2017, mbasi shqyrtoi propozimin e Drejtorive Teknike mbi miratimin e rregullores për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike,

**Konstatoi se :**

- Referuar nenit 17 pika 4, ERE përcakton dhe miraton pagesën rregullatore që paguhet prej të licensuarve në përputhje me rregulloren përkatëse.
- Me Vendimin nr.136 datë 06.09.2017 të Bordit të ERE-s është miratuar fillimi i procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të rregullores përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike.
- Në përputhje me Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s draft rregullorja u publikua në median e shkruar dhe nëpërmjet komunikimit zyrtar u kërkua shprehja e opinionëve dhe komenteve nga ana shoqërive energjetike KESH sh.a., OST sh.a., OSHEE sh.a., shoqatave që veprojnë në sektorin e energjisë FIAA, AAES, AREA, ACERC, Shoqatës së Prodhuesve të Vegjël të Energjisë si edhe Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dhe Autoritetit të Konkurrencës.
- Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 386/1 Prot., datë 13.10.2017 adresuar ERE-s është shprehur se kjo rregullore nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar.
- Me shkresën nr. 22226/1 Prot. datë 10.10.2017, protokolluar në ERE, në datë 06.11.2017, jashtë afatit që parashikon rregullorja e Organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE ,OSHEE ka shprehur komentet e saj mbi këtë rregullore.
- Në datën 12.11.2017 u organizua në ERE seanca dëgjimore teknike me përfaqësues të shoqërisë OSHEE sh.a. ku u diskutua mbi problemet e ngritura dhe u dhanë sqarimet përkatëse.

- OSHEE sh.a. bëri me dije se metodologjia është e saktë dhe në interpretim të drejtë të legjislacionit në fuqi.
- OSHEE sh.a. propozoi llogaritjen e pagesës përkatëse rregullatore mbi shumën e arkëtuar të të ardhurave në vitin e mbyllur financiar, duke bërë me dije se të ardhurat e arkëtuara janë më të vogla se ato të faturuara.
- ERE i la detyrë shoqërisë OSHEE sh.a. që të propozojë zyrtarisht formulën e arsyetuar e në zbatim të ligjit.
- Nuk rezulton të jetë depozituar në ERE një propozim për sa më sipër në përfundim të afatit të përcaktuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të miratojë *“Rregulloren për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike.”* (Bashkëlidhur)
2. Drejtoria e Administrim Financës dhe Burimeve Njerëzore të njoftojë të licensuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit AHMETI**



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**  
**Bordi**

**Votimi i Bordit të ERE për,**

**VENDIMIN**

**Nr. 190, Datë 23.11.2017**

**MBI**  
**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E PAGESAVE TË**  
**RREGULLIMIT PËR TË LICENSUARIT NË SEKTORIN E ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE**

**Anëtarët e Bordit**

	Pro	Kundër
<b>Petrit Ahmeti</b>	_____	_____
<b>Adriatik Bego</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Maksim Shuli</b>	_____	_____